

Mark Gurakuqi:

**Autorë dhe probleme të viteve '30,**

**Tiranë, 1966, 280 f.**

Letërsia shqiptare e periudhës 1912-1939 në tërësi, si dhe letërsia e rrymës demokratike që mori hov zhvillimi sidomos në vitet '30, është bërë objekt studimi të vërtetë shkencor vetëm pas çlirimit. Studimet e së kaluarës u përqendruan kryesisht në ato figura që shprehën tendencat më reaksionare të epokës, duke lënë në harresë prodhimin letrar të rrymës demokratike, në të cilën u pasqyruan synimet dhe aspiratat e shtresave të gjera të popullit për shndërrime me karakter demokratik.

Shkenca jonë e re letrare zbuloi vlerat e vërteta ideore dhe artistike të letërsisë së viteve '30 dhe shpjegoi drejt karakterin e kësaj letërsie duke u mbështetur mbi një kuptim të drejtë shkencor të etapës në të cilën ajo lindi, të drejtimit të luftës shoqërore e ideologjike që u zhvillua në ato vite në Shqipëri. Tanimë janë zbuluar rrënjët shoqërore të letërsisë përparimtare të viteve '30, si një letërsi e përfutur nga lëvizja e shtresave demokratike kundër rendit çifligaro-borgjez.

Në këtë prizëm ka qenë studjuar krijimtaria letrare e disa prej autorëve më të mirë të atyre viteve, si p.sh. ajo e Migjenit, F.S. Nolit etj. Por, megjithë sukseset e arritura, shkenca letrare në studimin e letërsisë përparimtare demokratike të viteve '30 ka bërë vetëm hapat e para.

Midis studjuesve që janë marrë më shumë me studimin e kësaj periudhe është dhe Mark Gurakuqi, i cili ka dhënë një kontribut të dukshëm me punimet e tij për autorë të veçantë të kësaj etape të letërsisë shqiptare.

Në veprën «Autorë dhe probleme të viteve '30» janë përmbledhur një sërë artikujsh studimorë, një pjesë prej të cilëve autori i kishte botuar më parë në shtyp. Duke analizuar letërsinë me brendi demokratike të kësaj periudhe, M. Gurakuqi vë në dukje se ajo jo vetëm nuk e idealizoi jetën e prapambetur, gjendjen e mjeruar të popullit tonë, siç bëri letërsia e rrymës klerikalo-borgjeze, por e pasqyroi jetën ashtu siç ishte, duke u përpjekur të tregonte dhe shkaqet e një gjendjeje të tillë. Në konceptin e përgjithshëm të autorit për letërsinë demokratike të viteve '30 tërheq vëmendjen fakti se në të ai sheh të kryhet jo vetëm procesi i formimit të realizmit por edhe dalja e elementeve të letërsisë së re, të realizmit socialist.

Në këtë vepër M. Gurakuqi ka analizuar krijimtarinë letrare të një vargu autorësh të viteve '30, për të cilët jep mendimin e vet, shpeshherë në kundërshtim me mendimet e shprehura më parë.

Kështu që vepra «Autorë dhe probleme të viteve '30», për problemet që trajton dhe mendimet e autorit për letërsinë dhe talentet e viteve '30, ka një rëndësi e vlerë të veçantë për historinë e letërsisë shqiptare.

Në vepër janë përmbledhur këta artikuj: «Çështje të tematikës dhe zhvillimit të realizmit në letërsinë tonë përparimtare të viteve '30», «Disa probleme dhe veçori të artit të Migjenit», «Pasqyrimi i jetës së qytetit në veprën e Migjenit», «Krijimi letrar i Nonda Bulkës (Chri-Chriut) në vitet '30», «Krijimi poetik i Kapës (Kristaq Cepës) në vitet '30», «Një poezi qytetare e revolucionare», «Me sytë drejtë së ardhmes», «Kur zgjohej një botë» dhe «Hyj që nuk shuhem».

\* \* \*

Në artikullin e parë «Çështje të tematikës dhe të zhvillimit të realizmit në letërsinë tonë përparimtare të viteve '30» trajtohet problemi i përgjithshëm teorik i lindjes, formimit dhe konsolidimit të realizmit në letërsinë tonë.

Në fazën e fundit të Rilindjes sonë kombëtare në fillim të shekullit XX, kur ndodhën ndryshime të rëndësishme social-ekonomike, sidomos pas formimit të shtetit shqiptar, autori vë re lindjen e metodës realiste dhe në vitet '20 e '30 formimin e konsolidimin e saj.

Mirëpo kur shpjegon shkaqet kryesore për lindjen e formimin e realizmit tek ne, autori, përveç ndryshimeve social-ekonomike, thekson dhe trajtimin e temave shoqërore në letërsinë tonë të asaj kohe, duke e parë realizmin jo si një metodë krijuese që kushtëzohet nga mënyra e pasqyrimin të jetës, por si diçka që vjen si pasojë e trajtimit të tematikës shoqërore në letërsi.

Vitet '30 konsiderohen nga autori si faza e pjekurisë dhe e konsolidimit të realizmit në letërsinë tonë. Midis atyre që dhanë kontributin më të madh për këtë konsolidim përmenden N. Bulka, Dh. Shuteriqi, A. Varfi etj., të cilët nëpër artikuj të ndryshëm me karakter teorik kërkuan një letërsi realiste që të pasqyronte jetën, vuajtjet e popullit dhe luftën e tij për një jetë më të mirë.

Lidhur me letërsinë përparimtare të viteve '30, ka qenë shprehur mendimi se në këtë dekadë e ndoshta dhe më parë, me disa poezi të Nolit e ndonjë tjetri, fillon në letërsinë tonë realizmi socialist. M. Gurakuqi ndonëse e hedh poshtë këtë mendim, kur formulon tezën në thelb, ripohon fillimet e realizmit socialist në letërsinë përparimtare të viteve '30. Ai shkruan: «Nëse duem të flasim për hapa e shkallë drejt kësaj metode, shkalla e parë e hapi i parë, qoftë ende i pasigurtë e fillestar, u ba në vitet '30». <sup>2</sup> Ndërsa në periudhën e Luftës nacionalçlirimtare, ai vendos formimin e realizmit socialist dhe pjekurinë e kësaj metode pas çlirimit, në vitet 1950-1952.

Sot pas më se 5 vjetësh që nga botimi i veprës, kjo tezë mbi lindjen dhe formimin e realizmit socialist në letërsinë tonë nuk është më e pranueshme. Shkenca jonë letrare ka përqaftuar tezën sipas së cilës realizmi socialist tek ne nisi të nxjerrë kryet në periudhën e Luftës nacionalçlirimtare dhe u formua si metodë krijuese pas çlirimit, kur parimet e reja të njohjes e të pasqyrimin artistik të jetës u manifestuan në krijimtarinë letrare të shkrimtarëve të sotëm në tërësinë dhe unitetin e tyre.

Së fundi duhet të vëmë në dukje se në këtë artikull ndjehet një pasaktësi në përdorimin e një sërë termash shkencore si metodë, rrymë, metodë e realizmit socialist gjë që na jep të kuptojmë mbi një paqartësi teorike të autorit.

\* \* \*

Në artikujt «Disa probleme dhe veçori të artit të Migjenit» dhe «Pasqyrimi i jetës së qytetit në veprën e Migjenit», autori ka shtjelluar disa çështje të rëndësishme të krijimtarisë së Migjenit. Në fillim sqarohen vlerat e veçanta të këtij poeti të talentuar ndaj bashkëkohësve, duke i parë këto vlera në talentin, në pjekurinë dhe në thellësinë me të cilën Migjeni pasqyroi problemet shoqërore të kohës.

Lidhur me mendimet e shprehura më parë për ndikimin e Migjenit nga letërsia e huaj, autori mban një qëndrim të ri. Ai e konsideron qëndrimin e më-

2) «Autorë dhe probleme të viteve '30», f. 34.

parshëm si një mbivlerësim dhe shpjegon se ky ndikim është i pjesshëm dhe jo-përcaktues.

Me interes është dhe trajtimi i problemit të të ashtuquajturit pesimizëm i Migjenit. Autori nuk pajtohet me dy mendimet e mëparshme. Ai nuk pranon që të mbitheksohet apo të interpretohet e thjeshtësuar kjo çështje dhe njëkohësisht nuk lejon që të kalohet pa vënë re. M. Gurakuqi, pasi thekson se poeti nuk ka nevojë për falje e shpirtmadhësi të tillë, shkruan «... te Migjeni ka nota trishtimi, melankolie e që herë herë mund të marrin thekse «pesimiste», por që s'kanë të bënë me konceptin e tij të përgjithshëm mbi jetën, me botëkuptimin e tij. Ata janë vetëm momente, përcaktue nga disa faktorë objektivë e subjektivë, nga disa rrethana konkrete, por në asnjë mënyrë nuk mund të spieghohen vetëm me sëmundjen e tij, sado e randë që qe kjo». <sup>3</sup>

Tek pesimizmi i disa poezive autori i studimit sheh hidhërimin e poetit për dobësinë e lëvizjes demokratike-revolucionare. Në ndonjë poezi tjetër ai gjen një lodhje të përkohshme të një poeti kryengritës dhe jo një nënshtrim të pashpresë.

M. Gurakuqi gjente tek Migjeni një poet të mendimit, një poet qytetar që e përdori artin si mjet lufte.

Në punimin e dytë për Migjenin është kapur dhe novatorizmi si një tipar karakteristik i veprës së poetit. Ky novatorizëm shihet në thellësinë e shtjellimit të temave dhe në mënyrën e pasqyrit të jetës nga shkrimtari, i cili nuk mbeti në përshkrimin e mjerimit, por zbuloi edhe shkaqet e këtij mjerimi.

Autorin e ka tërhequr edhe krijimtaria e dy shkrimtarëve të tjerë përparimtarë: N. Bulkës dhe K. Cepës (Kapa).

Tipari i parë që i bashkon këta dy talente të viteve '30 ishte metoda realiste dhe përpjekjet e tyre për ta pasqyruar jetën në shumanshmërinë e saj. Humori, patosi demaskues dhe guximi me të cilët ata trajtuan temat shoqërore, janë gjithashtu një anë e përbashkët e krijimtarisë së tyre, që ka vënë re studjuesi në artikujt e përmbledhjes kushtuar krijimtarisë së këtyre dy autorëve. Duke analizuar tematikën dhe realizmin e N. Bulkës dhe të K. Cepës, Gurakuqi nënvizon se të dy goditën regjimin në fuqi, klerin, deputetët, imperializmin luftënxitës etj. Mirëpo, pikërisht këtu vihet re se ata nuk ecën dot njësoj në këtë rrugë: N. Bulka nuk eci dot më tej se kjo kritikë, ndërsa Kapa, sipas mendimit të autorit, mbrapa humorit e ironisë dha notat e revoltës dhe dëshirën për të kapur perspektivën, të ardhmen. Mirëpo duke qenë se autori arrin në këtë konkluzion duke u mbështetur vetëm në poezinë «Intervistë me Doktor Kavalierë», me të cilën poeti nuk ka dashur të shprehë «mendimin për një shoqëni të ardhëshme ma të mirë», por ka vënë në lojë ata persona që në prag të zgjedhjeve parlamentare premtorin programe përparimtare për të fituar sa më shumë vota, mund të themi se M. Gurakuqi ka kaluar më tej se sa të lejon poezia e K. Cepës. Nga ana tjetër vetë paraqitja e Doktor Kavalierit me nota tallëse tregon se poeti nuk ka dashur të japë me të një figurë pozitive që përpiket për një botë më të mirë.

Nga ana tjetër, autori vë në dukje se në luftën kundër klerit e fesë Kapa mbetet shumë prapa N. Bulkës, i cili me këtë luftë konsekuente dha kontributin e vet për demokratizimin dhe laicizimin e mëtejshëm të letërsisë sonë.

Veç anëve pozitive në krijimtarinë e N. Bulkës e të K. Cepës, vihet në dukje dhe një anë e dobët e krijimtarisë së tyre: qëndrimi negativ ndaj femrës. Autori, duke shpjeguar këtë ecje kundër rrymës, kundër përpjekjeve të përgjithshme të emancipimit, shpreh mendimin se këtu kemi të bëjmë me «nji modë të importueme nga jashtë» <sup>4</sup>, me një influencë të letërsisë borgjeze franceze me tendenca dekadente.

3) Po aty, f. 42.

4) Po aty, f. 127.

Në tërësi, si përfundim, mendojmë se autori e ka mbivlerësuar krijimtarinë poetike të K. Cepës përse i përket përmbajtjes dhe ka bërë lëshime për anën artistike të saj. Poezia e Kapës ka një ndërtim të dobët, me figura artistike tepër të ralla dhe shpeshherë ka mbetur një vargëzim i thjeshtë.

\* \* \*

Në artikujt «Nji poezi qytetare e revolucionare», «Me sytë drejt së ardhmes» dhe «Kur zgjohej nji botë...» analizohet krijimtaria letrare e P. Markos, A. Çaçit dhe A. Varfit, në vitet '30.

Autori, duke analizuar poezitë më të mira të këtyre poetëve, të cilat i quan poezi qytetare e revolucionare, përpiqet të argumentojë tezën e vet mbi shfaqjen e elementeve të realizmit socialist në letërsinë tonë të viteve '30. Kështu, duke analizuar poezinë e P. Markos, M. Gurakuqi shkruan: «Në qoftë se studjuesit e historisë së letërsisë sonë duan të hulumtojnë elementët e parë të nji letërsie shqipe socialiste, para Luftës Nacional-Çlirimtare, për mendjen tonë s'kanë si mos ndalen të analizojnë vjershat e ciklit «Kënga e bajonetës» dhe përshtatjet e «Këngëve të Republikës» të P. Markos». <sup>5</sup>

Në poezitë më të mira të A. Çaçit autori sheh optimizmin, notat e protestës e të revoltës dhe përpjekjet e poetit për një «botë të re».

Duke dashur të zbulojë lidhjet e brendshme midis krijimeve të viteve '30 të A. Çaçit, me tendenca dhe elemente socialiste, me prodhimin e tij të mëvonshëm letrar, M. Gurakuqi analizon dhe poemën «Ashtu Myzeqe», me të cilën A. Çaçi u bë pas çlirimit (më 1946) një nga përfaqësuesit e parë të realizmit socialist tek ne. Prandaj ai shkruan: «Kërkimeve të maparshëm, andrimeve, dëshirës, përpjekjeve për nji «Botë të Re», por ende të papërcaktueme mirë, shfrimeve, hoveve, protestës së poezisë së tij të viteve '30, tani ia zë vendin një objektiv i qartë, nji Botë e Re konkrete, pjesëtar i së cilës asht vetë poeti». <sup>6</sup>

Nga shkrimet e A. Varfit, në këtë vepër janë trajtuar, përveç krijimeve letrare, dhe artikujt me karakter teorik, për të nxjerrë në dukje kërkesën e poetit për një letërsi proletare dhe me karakter kombëtar. Si veçori karakteristike në shkrimet e A. Varfit shënohen hovi revolucionar, shpirti luftarak dhe besimi në një botë tjetër më të mirë.

Si konkluzion, M. Gurakuqi jep mendimin se «autori i ri nuk kufizohej vetëm me kërkesën e nji letërsie thjeshtësisht realiste, ai synonte edhe ma larg, si na e vërteton dhe nji pjesë e krijimit të tij letrar origjinal». <sup>7</sup> Por, një konkluzion i tillë duhet pranuar me rezerva, mbasi siç dihet A. Varfi në vëllimin e vet «Në zgjim» ka përfshirë përveç disa artikujve e poezive të botuara në vitet '30 dhe mjaft skica e poezi të pabotuara që përbëjnë shumicën e veprës, të cilat ai i ka riprodhuar pas çlirimit, mbasi dorëshkrimet e para i kishin humbur.

\* \* \*

Në artikullin e fundit «Hyj që nuk shuhen» analizohet trashëgimi letrar i poetit Gaspër Pali.

Duke u nisur nga karakteristikat më tipike të poezisë së Palit, autori e radhit atë midis poetëve realistë të letërsisë sonë. Në poezitë e fazës së parë vihet re një hermetizëm, një mbyllje në vetvete e poetit, ndërsa në poezitë e viteve të fundit

5) Po aty, f. 185.

6) Po aty, f. 222.

7) Po aty, f. 234.

(1939-1941) M. Gurakuqi sheh një shkëputje nga ky hermetizëm dhe përpjekje për t'u bërë më të qarta e më shoqërore. E kjo s'është gjë tjetër veçse «fillimi i një procesi, që vdekja s'e la të shkojë deri në fund».

Duke e parë kronologjikisht krijimtarinë e këtij talenti, autori tregon se G. Pali, duke ecur drejt pjekurisë së tij, kalon nga një poet i mallit për atdhe, në një poet i aluzioneve kundër pushtimit fashist të vendit tonë. M. Gurakuqi ngrihet me të drejtë kundër një mendimi të shprehur në vëllimin me poezi «Hyjtë mbi greminë» (f. 64) sipas të cilit poeti «kërkonte rrugë me dritë dhe koha nuk ia diktonte». Ai sqaron drejt se kjo mosecje më tej se aluzionet kundër pushtimit fashist është një dobësi e poetit, sepse në atë kohë kishte mjaft të rinj që e kishin gjetur «rrugën me dritë», por poeti nuk u lidh dot me ta. Pa bërë lëshime, autori, duke u mbështetur mbi një analizë shkencore, jep konkluzionin e vet për gjithë krijimtarinë e G. Palit: «Poezia e tij përmban vetëm elemente pakënaqësie, dëshire për me luftue, por jo luftën në vetvete...»

Pa lënë në një anë dhe analizën artistike, autori shënon figurat më të përdorshme dhe dëshirën e përpjekjet e poetit për të shkruar në varg të lirë.

•

Si përfundim mund të themi se vepra «Autorë dhe probleme të viteve '30» është një vepër me vlerë dhe rëndësi të dukshme për historinë e studimeve tona letrare. Në të zgjidhen drejt një sërë problemesh, hidhen teza të reja e ngrihen një varg çështjesh që kërkojnë një studim të mëtejshëm nga shkenca jonë letrare.

Thanas Gjika

